

Në bazë të nenit 103 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/2021) dhe Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Drejtoria Rektoriale e miratoi vendimin në vijim:

PROGRAMI KUNDËR KORRUPSIONIT

Korrupsioni, si fenomen i dëmshëm dhe negativ në shoqëri, shkakton problem në ofrimin cilësor dhe efikas të arsimit të lartë dhe kryerjen e hulumtimeve shkencore në të gjitha universitetet në botë, madje edhe në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup. Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë veprimtarinë e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup (në vazhdim referuar si: UNT), në drejtim të forcimit të politikës së parandalimit të korrupsionit në arsimin e lartë. Hartimi i strategjive efektive kundër korrupsionit në UNT kërkon njohjen e formave të ndryshme përmes të cilave manifestohet korrupsioni në arsimin e lartë, gjë që do të mundësonte qasjeje sa më të përshtatshme kundër korrupsionit. Për këtë arsye, UNT miraton Programin Kundër Korrupsionit, i cili përfshin një grup masash kundër korrupsionit që do të ndërtojnë dhe promovojnë integritetin e Universitetit.

Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kodin Etik të UNT-së, UNT e kryen punën në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në mënyrë ligjore, profesionale, të ndershme dhe etike. UNT e kryen punën duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin për të punësuarit në Sektorin Publik dhe kuadrin ligjor përkatës për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, procedurat për prokurimin publik, punët financiare, auditimin e brendshëm financiar, punësimin dhe avancimin, mbrojtjen e treguesve dhe qasjen e lirë në informacionin publik.

UNT zbaton një politikë të mos tolerimit të asnjë forme të korrupsionit në kuadër të punës së universitetit. UNT ka për qëllim punën profesionale me ruajtjen e integritetit të punonjësve, studentëve dhe të gjithë personave të tretë me cilët bashkëpunon dhe përkushtohet në krijimin dhe zbatimin e sistemeve efektive për parandalimin e korrupsionit.

Në UNT korrupsioni kuptohet si: çdo veprim ose mosveprim i kryer nga një anëtar i komunitetit universitar në kryerjen e veprimtarisë dhe detyrimit të tij të punës dhe në këmbim të të cilit ai kërkon ose pranon ndonjë përfitim ose interes për veten ose një person tjetër; çdo tejkalim dhe cënim i kryerjes së funksionit të zgjedhur në organet dhe trupat e UNT-së dhe njësisë të UNT-së; rregullat e përcaktuara për zhvillimin e kolokviumeve dhe provimeve, vlerësimin e esëve dhe punimeve seminarike, mbrojtjen e punimeve të diplomës dhe masterit, përzgjedhje në thirrje etj., për shkak të një përfitimi, komoditeti, avantazhi ose interesi tjetër të premtuar, të ofruar, të dhënë, të kërkuar, të pranuar ose të pritur material ose jomaterial në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga një anëtar i komunitetit universitar, qoftë për vete ose për dikë tjetër.

Në arsimin e lartë korrupsioni përfshin kryesisht abuzimin e autoritetit të stafit pedagogjik, bartës të detyrës dhe punonjës të tjerë të Universitetit, me qëllim të realizimit të përfitimit material, shërbimeve ose përfitimeve të tjera personale (dhurata, sponsorizime, angazhimet e ekspertëve, udhëtimet, ndikimet politike etj.), në këmbim të lëshimeve jo selektive, të drejta dhe me lëshime të papranueshme në zhvillimin e kolokviumeve, provimeve, mbrojtjeve të tezave të magistraturës, dhe disertacionet e doktoraturës, abuzimet në dhënien e vërtetimeve, certifikatave dhe diplomave.

Ky program ka për qëllim marrjen e masave parandaluese për krijimin e kushteve të pafavorshme për sjellje joetike dhe korruptive të punonjësve të UNT-së, studentëve dhe të gjithë palëve të treta me të cilat bashkëpunon UNT.

1. AKTIVITETET E PROGRAMIT

Aktivitetet e antikorrupsionit kanë për qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve dhe studentëve të UNT-së që të arrihet një shkallë e lartë e profesionalizmit dhe integritet në realizimin e programeve studimore, veprimtaritë kërkimore dhe aplikative të Universitetit, të cilat do ndikojnë në uljen e dukurive dhe sjelljeve korruptive.

Sipas asaj që ceket më lartë, Programi i UNT-së Kundër Korrupsionit për vitin akademik 2022/2023 do t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- parandalimit, që nënkupton heqjen e shkaqeve të korrupsionit
- ndërgjegjësimin të punonjësve dhe studentëve për domosdoshmërinë e profesionalizmit të lartë në veprim;
- forcimin e integritetit të punonjësve;
- ngritjen e standardeve etike në nivelin më të lartë.

Qëllimet priorotare do të jenë:

1. rritja e llogaridhënies dhe transparencës së punës së UNT-së;
2. dixhitalizimi i shërbimeve;
3. promovimi i integritetit të personelit mësimor, punonjësve dhe studentëve;
4. promovimi dhe zbatimi i vazhdueshëm i Kodit të Etikës së UNT-së;
5. trajnimi i vazhdueshëm dhe i specializuar të stafit akademik dhe të punësuarve në UNT;
6. motivimi i studentëve të UNT-së për të raportuar korrupsionin;
7. konfirmimi i personit të autorizuar për pranimin e raporteve për korrupsion

1.1. Rritja e llogaridhënies dhe transparencës së punës së UNT-së

Llogaridhënia do të thotë se të gjithë të punësuarit në UNT përfshirë këtu organet udhëheqëse të njësive, si dhe i gjithë stafi akademik dhe administrativ, bëhen të përgjegjshëm, argumentojnë dhe shpjegojnë vendimet dhe veprimet e tyre. Qëllimi i llogaridhënies është të përforcohet bashkëpunimi i ndërsjellë brenda dhe ndërmjet njësive si dhe organeve të UNT-së, integriteti i stafit akademik, si dhe për të rritur besimin e studentëve.

Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme që UNT ta informojë publikun për rregulloret, vendimet dhe punën e përgjithshme si dhe duhet të jetë i hapur dhe të ofrojë qasje të lehtë për të gjithë.

Me transparencë në funksionimin e UNT-së nënkuptohet qasje më e lehtë për publikun në rregulloret, buletinet, projektet, vendimet, procedurat, kurrikulat, prokurimet publike, buxhetet dhe informacion për aktivitetet e planifikuara dhe të ndërmarra të organeve të UNT-së dhe njësive të tij. Informacioni duhet të jetë në kohë, relevant dhe të ketë qasje të lehtë për publikun.

UNT do ta përforcojë bashkëpunimin me mediat, si dhe me organizatat studentore dhe rinore me qëllim që të promovoj politikat dhe aktivitetet e saj në fushën e arsimit të lartë, të veprimtarisë aplikative dhe shkencës. Për këtë qëllim, UNT-ja do të ndërmerr masat në vazhdim:

- shpallje publike, në mënyrë të unifikuar, përbërjen e të gjithë informacionit përkatës për studentët, punonjësit dhe përdoruesit e tjerë të shërbimeve, në faqet e internetit të UNT-së dhe njësive të tij;
- Zbatimi i plotë i dispozitave të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet me karakter publik;
- informimi i studentëve për mekanizmat e parandalimit të të gjitha llojeve të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe hartës së rrezeve të korrupsionit;
- disponueshmëria e rezultateve të anketave për vlerësimin e stafit akademik, nga ana e studentëve.

1.2 Dixhitalizimi i shërbimeve

Me dixhitalizimin e shërbimeve për të gjitha kategoritë e studentëve të UNT-së, të ofruara nga Universiteti dhe njësitë përbërëse të tij, rritet edhe transparenca, efektiviteti, efikasiteti, qasja, kontrollimi dhe analiza e të dhënave të UNT-së. Vetëm sistemet e integruara mirë, të cilat përmbajnë të dhëna të verifikuara, të sinkronizuara dhe të sakta, dhe që nga ana tjetër reduktojnë faktorin njerëzor në vetë proceset, mund të kontribuojnë në uljen e korrupsionit dhe zbulimin e lehtë të të gjitha abuzimeve që kanë ndodhur. Me vetë procesin e dixhitalizimit dhe ofrimit të shërbimeve ndaj studentëve, është e nevojshme të promovohet kuptimi i dokumenteve elektronike jo vetëm për përdoruesit e shërbimeve, por edhe për stafin e punësuar në UNT, si dhe realizimin e trajnimeve të nevojshme për përdorimin e teknologjisë dixhitale.

1.3 Promovimi i integritetit të personelit mësimor, punonjësve dhe studentëve

Integriteti i stafit mësimor të UNT-së është parim i sjelljes së vazhdueshme të tij në përputhje me vlerat etike. Integriteti i profesorit kërkon që puna e profesorit të jetë në përputhje me vlerat etike të përcaktuara qartë, si p.sh. barazia, paanshmëria, drejtësia dhe ndershmëria. UNT duhet të promovojë integritetin në të gjitha nivelet e tij. Profesorët janë të detyruar që sjelljen e tyre ta përshtasin me vlerat etike të përcaktuara në Kodin e Etikës së UNT-së. I gjithë stafi mësimdhënës, si dhe të gjithë punonjësit dhe personat e tjerë të angazhuar të UNT-së, duhet të zotërojnë njohuri dhe aftësi, kapacitet etik, dhe profesionalizëm përmes respektimit të rregullave të vendosura.

E rëndësishme është integriteti i anëtarëve të organeve drejtuese të UNT-së, si dhe anëtarëve të Senatit, Drejtorisë Rektoriale, prorektorëve dhe rektorit të UNT-së, të cilët përmes vendosjes së vlerave të larta profesionale duhet të mundësojnë respektimin e rregullave dhe dispozitave gjatë punës së punësuarve dhe studentëve, si dhe respektimin e vlerave etike.

1.4 Promovimi dhe zbatimi i vazhdueshëm i Kodit të Etikës së UNT-së

Kodi i Etikës së UNT-së zbatohet për personat e stafit akademik dhe administrativ. Ky kod gjithashtu vlen edhe për të gjithë ata persona që marrin pjesë në punën dhe veprimtarinë e Universitetit dhe për ato institucione me të cilat universiteti ka marrëveshje për bashkëpunim. Të gjithë personat e cekur duhet ta njohin mirë Kodin e Etikës së UNT-së, gjë që do të sigurojë ndërgjegjësimin për etikën dhe forcimin e integritetit të punonjësve të universitetit. Kodi i Etikës i UNT-së në mënyrë sistematike të kuptohet, pranohet dhe zbatohet nga të gjithë personat e përfshirë në të. Me respektimin e Kodit të Etikës nënkuptohet eliminimi i shumë arsyeve për shfaqjen e mundshme të korrupsionit në radhët e stafit akademik dhe administrativ si dhe në udhëheqësinë e universitetit. Kodi i Etikës identifikon të cilat konsiderohen të papranueshme dhe i nënshtrohen përgjegjësisë së përcaktuar në procedurë të përcaktuar dhe me sanksionet

përkatëse të vendosura nga komisionet për zbatimin e Kodit të Etikës së UNT-së, përkatësisht: Komisionit të Etikës së Universitetit, i krijuar nga Senati i Universitetit.

1.5. Trajnim i vazhdueshëm dhe i specializuar të stafit akademik dhe të punësuarve në UNT

Stafi i universitetit, në mbështetje dhe promovim të sistemit të karrierës i bazuar në profesionalizëm, është e nevojshme të trajnohen për njohuritë dhe qëllimet të punës profesionale dhe etike për të qenë në gjendje të promovojë vlera të larta përmes punës së saj në publikun e gjerë, të promovojë standarde të larta në punën profesionale dhe etike. Kjo përfshin edhe ndërtimin e kapaciteteve për të zbuluar rreziqet e korrupsionit dhe zbatimin e masave efektive kundër korrupsionit. Në realizimin e këtij aktiviteti, rolin kryesor kanë organet drejtuese dhe udhëheqëse të UNT-së, si dhe njësitë e tij, të cilat duhet të organizojnë trajnime specifike dhe të vazhdueshme për të gjithë të punësuarit.

Për këtë qëllim është e nevojshme të përgatitet Program vjetor për trajnim për stafin e universitetit me tema të përshtatshme nga fusha e antikorrupsionit në arsimin e lartë, me shembuj nga praktika e përditshme dhe me theks të veçantë në mangësitë e perceptuara nga puna e mëparshme.

1.6 Motivimi i studentëve të UNT-së për të raportuar korrupsionin

Studentët janë ndër personat kryesor në zbulimin e korrupsionit në Universitet dhe është e nevojshme që ti motivojmë dhe ta rrisim vetëdijen tek studentët sepse në shumicën e rasteve të korrupsionit nuk mund të zbulohen pa pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre aktive në proces. Studentët nuk marrin pjesë aktive dhe hezitojnë ta paraqesin korrupsionin për shkaqe subjektive dhe për shkak të pasojave të mundshme. Prandaj, në universitet me qëllim të ndërgjegjësimit të studentëve për rreziqet e korrupsionit në arsimin e lartë duhet të organizojmë takime seminare, tryeza të rrumbullakta dhe aktivitete të tjera të cilat kanë për qëllim parandalimin e korrupsionit.

1.7. Konfirmimi i personit të autorizuar për pranimin e raporteve për korrupsion

Personi i autorizuar për pranimin e raporteve për korrupsion në UNT, është person i emëruar nga stafi akademik gjegjësisht profesor në UNT, i cili është i detyruar të pranojë raportet për korrupsion, të mbrojtë identitetin e raportuesve nëse është e nevojshme si dhe të dorëzojë raporte të rregullta gjatë muajve për në Senatin e UNT-së, raporte të cilat do të shërbejnë si bazë për përgatitjen e analizave dhe planeve të veprimit për parandalimin e korrupsionit në UNT. Udhëheqësia dhe njësitë përbërëse të UNT-së duhet të përkushtohen në parandalimin e konfliktit të interesave, duke përdorur të gjitha mekanizmat ligjorë dhe etikë për shmangien e tij. Ekziston një lidhje e qartë midis korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Korrupsioni shpesh mund të përfshijë raste të konfliktit të interesit, por jo të gjitha rastet e konfliktit të interesit janë njëkohësisht raste korrupsioni.